

**SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT TË MATURËS NGA  
GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, JANAR 2018**

1. Nxënësi/nxënësja\* merr **1 pikë** nëse shkruan: *Radio Dojçe Vele*
2. Është rrethuar numri 1: *Të shkohet për të fjetur - 1 pikë*
3. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Pjesa e trurit në të cilën përherë vendosen informacionet./Ai është neokorteksi. (dhe përgjigje tjera të ngjashme)*
4. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Bjorn Rash dhe kolegët e tij konsideronin që në gjumë ndodhin të njëjtat gjëra sikur në gjendje të zgjuar dhe se mësimi i informacioneve të njëpasnjëshme pengon mbajtjen mend të informacionit të parë. (dhe përgjigje tjera të ngjashme)*
5. A) Është rrethuar numri 3: *Riaktivizimi i kujtesës është ndryshe në gjendje të zgjuar sesa në gjumë – 1 pikë*  
  
B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse përshkruan ose perifrazon fjalinë: ... *arsyeja për këtë rezultat befasues është fakti që në minutat e para të gjumit filloi përcjellja e të dhënave nga hipokampusi në neokorteks. (dhe përgjigje tjera të ngjashme)*
6. Është rrethuar numri 2: *Biografi e shkrimtarit të njohur Andrej Makin - 1 pikë*
7. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Atë vit ka botuar romanin Testamenti francez për të cilin ka marr shpërblimet Gonkur dhe Medisis dhe është bërë i njohur. (dhe përgjigje tjera të sakta)*
8. A) Është rrethuar numri 1: *një roman – 1 pikë*  
  
B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Pas shpërblimeve Gonkur dhe Medisis boton tre romane, por shpërblimin e RTL Lyrës e fiton vetëm për romanin Muzika e një jete i cili është botuar në vitin 2001. (dhe përgjigje tjera të sakta)*
9. Nxënësi merr **1 pikë** për dy ose tre përgjigje të sakta: *Krasnojarsk, Moskë, Paris.*
10. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Libri më i mirë/Libri që aktualisht kërkohet më së shumti dhe shitet më së miri./Libri që ka shitje më të mirë.*

---

\*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

11. A) Është rrethuar numri 2: *Andrej Makin (1957) ka lindur në Krasnojarsk.* - **1 pikë**  
B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Pas vitit asnjëherë nuk shkruhet pika.*
12. Nxënësi merr **2 pikë** për pesë ose gjashtë përgjigje të sakta: *i përditSHëm, ZHduk, i përshtatSHëm, vajÇa, ZHgardhoj, ZHgradim.*  
  
Nxënësi merr **1 pikë** për tri ose katër përgjigje të sakta.
13. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Poema shquhet për trajtimin e temës sociale.*  
Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka një shprehje më të plotë sikurse: *Poema shquhet për notat realiste në trajtimin e temës sociale të fatit dhe të dramës së mërgimtarëve.*
14. Është rrethuar numri 2: *Migjenit* – **1 pikë**
15. Nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethon PO dhe shkruan: *Sepse ritmi i vargut ka një ecuri origjinale, sipas valës së ndjenjave dhe ideve që e përshkojnë poetin dhe nuk i nënshtrohet skemave të metrikës tradicionale. (dhe përgjigje të tjera të sakta)*
16. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Mekuli me këto vargje paraqet vrazhdësinë dhe brutalitetin e jetës. (dhe përgjigje tjera të sakta)*
17. A) Është rrethuar numri 3: *gjen në mjedisin e tij* – **1 pikë**  
B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Mekuli përdor figurën e metaforës.*
18. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*  
B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Dritëro Agolli*
19. A) Është rrethuar numri 3: *Roman satirik* – **1 pikë**  
B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Autori në këtë roman vë në lojë burokracinë, hipokrizinë dhe servilizmin e njerëzve të asaj kohe. (dhe përgjigje tjera të sakta)*
20. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Dialogun, rrëfimin*

21.A) Është rrethuar numri 3: Zyko Kamberi – **1 pikë**

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Konsiderohet i tillë sepse, megjithëse nuk është ai rrëfimtari, ngjarjet përqendrohen rreth tij.*

22. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Në mënyrë të përmbledhur ngjarjet lidhen me kulmin e karrierës së shokut Zylo dhe rënien e tij nga ana profesionale. (dhe përgjigje tjera të sakta)*

Nxënësi merr **2 pikë** nëse shkruan një përgjigje më të plotë dhe me stil.

23. Është rrethuar numri 3: *për keqardhje* – **1 pikë**

24. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Ndizet ndër vete, prishet pasi ka ndenjur pa ajrosur, myket etj.*

25. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *katën*

26. Gjithsej **3 pikë** – nxënësi merr nga **1 pikë** nëse shkruan saktë titullin e veprës dhe autorin që e ka shkruar:

*Dundo Maroje, Marin Drzhiq (1 pikë)*

*Gjahu i malësorëve, Konstandin Kristoforidhi (1 pikë)*

*Liria, Ndre Mjeda (1 pikë)*

27. Gjithsej **2 pikë** – nxënësi merr **1 pikë** për gjininë letrare të caktuar saktë dhe **1 pikë** për llojin e saktë letrar.

gjinia letrare: *dramë*

lloji letrar: *tragjedi*

28. Nxënësi merr **1 pikë** për përmirësimin e gabimeve në fjalinë e dhënë dhe për përshkrimin e saj pa gabime:  
*Sa për atë, kishte pamjen e njeriut që thotë: “Pa të shohim si do t’ia bësh tani.”*

29. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan:

*e kishte përfolur – përfliste*

*e kishte shpërlarë – shpërlante*

**30. Skema për vlerësimin e esesë: Analiza e poezisë *Kroj i fshatit t'onë***

<b>Kërkesa</b> <b>1.</b>	Nxënësi thekson se: - autori i kësaj poezie është Lasgush Poradeci <b>(1 pikë)</b> - vendi i zhvillimit të ngjarjes është kroj i fshatit <b>(1 pikë)</b> - poezia trajton vendin e pikëpjekjes së të rinjve dhe shfaqjen e dashurisë së tyre <b>(1 pikë)</b> <b>Gjithsej 3 pikë</b>
<b>Kërkesa</b> <b>2.</b>	Nxënësi thekson se poezia: - bën pjesë në përmbledhjen “Vallja e Yjeve” <b>(1 pikë)</b> - ka tiparet e një poemthi lirik <b>(1 pikë)</b> - është e ndarë në tri pjesë <b>(1 pikë)</b> . <i>Për një përgjigje më të plote dhe me stil 1 pikë.</i> <b>Gjithsej 4 pikë</b>
<b>Kërkesa</b> <b>3.</b>	Nxënësi shkruan për subjektin e poemthit: - pjesën e parë të kësaj poezie ku poeti jep pamjen e jashtme të vashave që shkojnë për të mbushur ujë <b>(1 pikë)</b> - pjesën e dytë ku përshkruhet vajtja e trimave në krrua për të këmbyer ndonjë fjalë me vashat <b>(1 pikë)</b> - pjesën e tretë dashurinë e të rinjve të cilën poeti e identifikon me rrjedhën dhe shijen e ujit të kroit <b>(1 pikë)</b> - veçon ndonjë figurë stilistike <b>(1 pikë)</b> - thekson notat idilike që e përshkojnë këtë poezi <b>(1 pikë)</b>  Nxënësi shpjegon funksionin e figurave stilistike <b>(1 pikë)</b> <b>Gjithsej 6 pikë</b>
<b>Kërkesa</b> <b>4.</b>	Nxënësi thekson: - se poezia <i>Kroj i fshatit t'onë</i> është hartuar me një varg popullor 12 rrokësh me cezurë në mes të vargut <b>(1 pikë)</b>  <i>Për një përgjigje më të plote dhe me stil 1 pikë.</i> <b>Gjithsej 2 pikë</b>

## Gjuha dhe forma e tekstit

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
<p>origjinaliteti (interpretion me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil</p> <p><b>3 pikë</b></p> <p>origjinaliteti (interpretion me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p>	<p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), e kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave <b>r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë</b>, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i</p>	<p>lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)</p> <p><b>2 pikë</b></p>

	<p>rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <b>j</b>)</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p>		
<p>përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj.)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>, moszbatimi i rregullave</p>		<p>ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p><b>1 pikë</b></p>

	<p>sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>		
--	---	--	--

**Skema për vlerësimin e esesë: SI USHQEHESH – ASHTU MENDON, SI MENDON – ASHTU JETON**

<b>Kërkesa 1.</b>	<p>Nxënësi kumton qëndrimin e vet për të ushqyerit e njeriut modern <b>(1 pikë).</b></p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil (1 pikë).</i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>
<b>Kërkesa 2.</b>	<p>Nxënësi kumton qëndrimin e vet për mënyrën e të ushqyerit të bashkëmoshatarëve të tij (ushqimi i shpejtë, hamburgerët, sandviçët...) <b>(1 pikë).</b></p> <p><i>Për një kumtim më të plotë të qëndrimit (1 pikë).</i></p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil (1 pikë).</i></p> <p><b>Gjithsej 3 pikë</b></p>
<b>Kërkesa 3.</b>	<p>Nxënësi thekson:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përparësitë e konsumimit të ushqimit të shpejtë <b>(1 pikë).</b></li> </ul> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil (1 pikë).</i></p> <p>Nxënësi thekson:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mangësitë e konsumimit të ushqimit të shpejtë <b>(1 pikë).</b></li> </ul> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil (1 pikë).</i></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p>
<b>Kërkesa 4.</b>	<p>Nxënësi thekson:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- sëmundjet e mundshme të cilat i shkakton mënyra bashkëkohore e të ushqyerit (p.sh. shtypjen e lartë të gjakut, trashjen, diabetin...) <b>(1 pikë).</b></li> </ul> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil (1 pikë).</i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>
<b>Kërkesa</b>	Nxënësi kumton:

5.	<p>- qëndrimin e vet për kultivimin e sjelljes së mirë pas tryezës <b>(1 pikë)</b>.</p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil (1 pikë).</i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>
<b>Kërkesa 6.</b>	<p>Nxënësi kumton mendimin e vet nëse ushqimi ndikon në shëndetin e njeriut ose jo dhe e argumenton qëndrimin e vet <b>(1 pikë)</b>.</p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil (1 pikë).</i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>

### Gjuha dhe forma e tekstit

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
<p>origjinaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil</p>	<p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), e kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali,</p>	<p>lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)</p>
<p><b>3 pikë</b></p> <p>origjinaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të</p>	<p>renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale</p>		<p><b>2 pikë</b></p>

<p>dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p>	<p><b>2 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave <b>r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë</b>, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <b>j</b>)</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p>		
<p>përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj.)</p> <p><b>1 pikë</b></p>		<p>ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p><b>1 pikë</b></p>

	<p>respektimi i normës drejtshkimore me gabime të pakta ( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>		
--	---	--	--